



Kultura në Kosovë:

ANALIZË E SHKURTËR

*Specia që
duhet shpëtuar*

Nëntor 2014, Prishtinë

Kultura në Kosovë:

ANALIZË E SHKURTËR

*Specia që
duhet shpëtuar*

Autor: **Florent Mehmeti**



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe i menaxhuar nga Zyra e
Bashkimit Europian në Kosovë



Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme Internacional Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian dhe Olof Palme International Center”

Përmbajtja

ÇKA PO SYNOHET? 6

Hyrje 7

1. FRENIMET 9

- 1.1. Kufizimet e qasjeve tradicionale 9
- 1.2. Sanksionimet kulturore 10
- 1.3. Arti dhe kultura: Hobi i orëve të mbrëmjes 10

2. MALLKIMET 12

- 2.1. Institutcionalofobia dhe burokratomania 12
- 2.2. Duke e ëndërruar shpërthimin e madh kulturor nga vendi i vogël 16
- 2.3. Gjithçka 1 euro – Të gjithë të lumtur në parajsën kulturore 17

3. SHANSET E HUMBURA – KULTURA ME FAJDE 18

4. VENDOSJA E TRENDIT ZHVILLIMOR NË KULTURË 20

- 4.1. Matja, identifikimi i potencialeve dhe analiza e mundësive 20
- 4.2. Praktikimi i politikave bashkëkohore të zhvillimit kulturor 23
- 4.3. Krijimi i terreneve fertile për zhvillim 23
- 4.4. Fuqizimi i parimeve të meritokracisë 24
- 4.5. Kritika artistike e kulturore 25
- 4.6. Decentralizimi dhe depolitizimi 26
- 4.7. Krijimi i procesit gjithëpërfshirës për mendim kreativ e strategjik për trasim të rrugës së zhvillimit kulturor 28

5. KULTURA NË LËVIZJE – HAPAT E ARDHSHËM 28

6. VERIFIKIMI I POLITIKAVE KULTURORE CILËSORE: PYETJE TË TJERA PËR T’U PASUR NË KONSIDERATË 29

Çka po synohet?

Ky punim synon që në mënyrë të përmbledhur të argumentojë nevojën për qasje strategjike ndaj zhvillimit kulturor në Kosovë.

Duke tentuar që të përmbledhë faktet, fenomenet dhe praktikatat më të rëndësishme të jetës kulturore të Kosovës sidomos të 15 vjetëve të fundit, ky punim synon t'i japë dritë një procesi konkret, i cili do të vendoste trendet zhvillimore në sektorin kulturor në Kosovë.

Duke qenë pjesë e iniciativës së Forumit Kulturor, rrjetit i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës, ky punim ka marrë për bazë të dhëna nga raporte të prodhuara nga kjo iniciativë, siç janë: “Pse na duhet një strategji e kulturës?”, përgatitur nga Forumi Kulturor, për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, “Hulumtimi i politikave qeverisëse në kulturë në Kosovë”, i bërë nga Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor për Forumin Kulturor si dhe raporti i hulumtimit “Politikat kulturore dhe ndarja e buxhetit për kulturën në Kosovë”, përgatitur nga Dren Pozhegu për Forumin Kulturor.

Megjithatë, ky punim, në masë të madhe, përkon me pikëpamjet dhe konceptet e zhvilluara të autorit nga përvoja e tij 20 vjeçare në sektorin e

kulturës, duke analizuar trendet dhe praktikatat e jetës kulturore në Kosovë, por edhe duke u bazuar në parime e praktika nga përvoja e tij ndërkombëtare në fushën e kulturës.

Duke mos tentuar që të krijojë një kornizë të ngurtë, ky punim synon të krijojë qartësi dhe të ofrojë udhëzime konkrete të ndërmarrjes së një procesi gjithëpërfshirës që do të vendoste Kulturën në kahe zhvillimore dhe pa hezitim do të ndikonte në masë të madhe në ngritjen e cilësisë së jetës kulturore në Kosovë.

Hyrje

Jeta kulturore në Kosovë: Çka ndërtuam e çka rrënuam? Si shkelëm mbi shanset e humbura? A kishim të trajektuar ndonjë rrugë kulturore si shoqëri? Për çka të mbahemi tash?

Për të analizuar dhe konstatuar gjendjen në sektorin kulturor sot, në vitin 2014, duhet trajtuar me kujdes të gjitha epokat historike të zhvillimit kulturor në Kosovë. Padyshim që zhvillimet shoqërore dhe politike kanë reflektuar në zhvillimet kulturore dhe sektori kulturor gjithnjë ka paguar faturën e shtrenjtë në kohët e turbullta të zhvillimeve shoqërore dhe politike. Si edhe në të gjitha sferat e jetës, edhe hovet e zhvillimeve kulturore pashmangshëm ndahen në epokën para dhe pas luftës në Kosovë të viteve 1998-1999.

Në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore, fundi i viteve të 60-ta si dhe vitet e 70-ta dhe 80-ta njihen si epokë kur pati një zhvillim më të hovshëm të gjithëmbarshtëm shoqëror, e me këtë pati edhe një zhvillim kulturor në Kosovë. Këto zhvillime mund të thuhet se vunë bazat e zhvillimeve më të hovshme kulturore në përgjithësi dhe ndikuan në zhvillimin profesional të veprimtarisë dhe prodhimtarisë artistike në Kosovë.

Kjo epokë konsolidon institucionet kulturore në Kosovë dhe fillon një periudhë e ekspozimit kulturor edhe jashtë kufijve të Kosovës.

Me okupimin edhe de jure të Kosovës dhe suspendimin e autonomisë në vitin 1989, fillon edhe epoka tjetër, e cila, deri në çlirimin e vitit 1999, njihet si epokë e errët shoqërore e sidomos kulturore. Veprimtaria kulturore zhvillohet jashtë institucioneve kulturore dhe ato pak zhvillime kulturore fillojnë të bëhen edhe lëvizje e rezistencës ndaj regjimit të instaluar në Kosovë. Kjo periudhë karakterizohet me aktivitete solidarizuese kulturore që mbajtën gjallë shpirtin e popullit nën okupim dhe në të njëjtën kohë lindjen e një brezi të ri artistësh, të cilët do të jenë bartës të zhvillimeve artistike të Kosovës së pasluftës. Edhe pse nën okupim, vitet e 90-ta krijojnë një lëvizje kulturore vibrante me një cilësi të mirë dhe karakterizohet me solidarizim, mbështetje dhe fuqizim të publikut, gjegjësisht popullit nën okupim.

Përderisa gjatë viteve të 90-ta arsytimi për zhvillime të vobekëta në sektorin kulturor ishte okupimi, ky arsytim nuk qëndronte më pas çlirimit të vitit 1999 dhe në një klimë shumëfish më të

favorshme dhe me burime e potenciale gjithnjë në rritje, Kosova dështon në këtë 15 vjetësh të krijojë baza të forta të zhvillimit të sektorit. Fillimisht ngërçet më të mëdha u krijuan nga administrata e UNMIK-ut (Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), që qeverisi Kosovën deri në shpalljen e pavarësisë në vitin 2008.

Edhe pse në masë të madhe qeverisja kulturore ishte në dorën e vendorëve dhe sidomos pas shpalljes së pavarësisë ku të gjitha kompetencat për qeverisjen e sektorit kulturor janë në duart e Qeverisë së Kosovës, shumë pak arrihet të bëhet për të pasur një sektor më të zhvilluar, më të konsoliduar dhe rrjedhimisht jetë më të dinjitetshme kulturore për qytetarët e Kosovës.

Ky punim synon që në mënyrë sa më të përmbledhur të analizojë dhe evidentojë huqjet, rrënimet, degradimet dhe shanset e humbura në të kaluarën, duke elaboruar mundësitë për një zhvillim strategjik kulturor nga perspektiva e sotme për të ardhmen.

Qëllimi i analizës të së kaluarës shërben ekskluzivisht për të pasqyruar qasjet dhe strategjitë e veprimit në mënyrë që të evitohen dështimet dhe

mossukseset e të kaluarës duke tentuar që të shfrytëzohet potenciali i plotë i zhvillimit të sektorit, gjithnjë duke pasur parasysh ekzistencën reale të resurseve që i posedon Kosova në sektorin kulturor.

1. Frenimet

Duhet konstatuar se këto 15 vitet e fundit nuk ka pasur apo ka pasur një zhvillim shumë të vobektë të sektorit kulturor.

Për këtë ekziston një konsensus i gjerë nga shumë studime, analiza e debate si të akterëve kulturorë po ashtu edhe nga rezultatet e hulumtimeve që janë bërë me vetë qytetarët si përfituesit e fundit dhe më të rëndësishëm të jetës kulturore. Kjo pjesë tenton të analizojë fenomenet, politikat dhe qasjet që kanë frenuar zhvillimet kulturore.

1.1 Kufizimet e qasjeve tradicionale

Duke u nisur prej mendësisë se kultura përfshin shënimin e disa datave të rëndësishme dhe një listing tjetër të aktiviteteve, në rrafshin politik qeverisja kulturore gjithnjë ka mbetur si kusuri i përmbylljes së marrëveshjeve të koalicioneve qeverisëse apo akomodim të figurave politike për të cilët nuk është gjetur ndonjë vend tjetër më joshës. E konceptuar si e tillë, rrjedhimisht në qeverisjen kulturore nuk janë përfshirë njohës të zhvillimeve kulturore, duke filluar prej posteve ministrore, drejtoritë komunale për kulturë e deri tek institucionet kulturore, të cilat shërbejnë si një listë bllanko për punësim, pa

marrë parasysh ekspertizën apo profilin e të punësuarve.

Duke e mbyllur kështu rrethin, kapaciteti si menaxherial apo intelektual, po ashtu edhe kreativ e artistik, në të shumtën e rasteve ka mbetur i papërfshirë dhe i papërfillur dhe në këtë mënyrë në masë të madhe është frenuar potenciali i zhvillimit të sektorit. Duke e menduar kulturën si një listing ngjarjesh kulturore krijohet përshtypja se menaxhimi është fare i lehtë, apo se secili mund ta bëjë. Kjo qasje ka përjashtuar plotësisht angazhimin dhe krijimin e politikave të ngritjes së kuadrove në mungesë, siç është menaxhimi kulturor apo edhe një mori profesioneve e profilesh aq të nevojshëm për ekzekutimin e programeve dhe projekteve kulturore. Qasja e tillë ka frenuar edhe zhvillimin e ekspertizës që është krijuar pa insentivën e parasë publike. Një numër personalitetesh që janë përfshirë në ndërmarrësi kulturore të suksesshme në Kosovë e që nuk janë pjesë e institucioneve dhe strukturave publike nuk kanë arritur të maksimalizojnë potencialin pikërisht si pasojë e kësaj qasje e cila nuk e njeh kulturën si sektor me premisa serioze si p.sh. sektori i energjisë apo ndonjë sektor tjetër i ngjashëm dhe rrjedhimisht nga

mungesa e përkrahjes së duhur ka frenuar në masë të madhe zhvillimin dhe profesionalizimin e mëtutjeshëm të këtij potenciali ekzistues.

1.2. Sanksionimet kulturore

Gjithnjë duke tentuar që të vendosen baza për një zhvillim më të mirë e të qëndrueshëm në sektor, në masë të madhe e iniciuar nga vetë komuniteti artistik, në 7-8 vitet e fundit ka ndodhur një bombardim legjislativ i sektorit. Një agjendë maratonike dhe shumë dinamike e prodhimit të legjislacionit kulturor është ndërmarrë duke anashkaluar në masë të madhe proceset gjithëpërfshirëse me të gjithë aktet e sektorit dhe duke organizuar debate ad hoc me përfshirje selektive. Ky legjislacion është krijuar pa kurrfarë politike dhe vizioni paraprak, por thjesht si edhe në aspektet tjera të jetës kulturore, prapë është përpiluar një listë ligjesh që dikush ka menduar se i duhen sektorit kulturor. Dëshira për të siguruar një performancë të institucioneve kulturore sipas vizionit të disa anëtarëve të komunitetit kulturor me ndikim në nivelet vendimmarrëse është përkthyer në numra që kanë zënë vend në nenet e legjislacionit kulturor. I miratuar nga Kuvendi i Kosovës, si organi më i

lartë ligjvënës i shtetit, ky legjislacion vazhdon të shkilet me të dy këmbët nga vetë institucionet e shtetit edhe në këto momente kur po shkruhen këto rreshta. Dëshira për të pasur ligje, duke tentuar të raportohet se po punohet, ka krijuar edhe anomali qesharake, siç është themelimi i bibliotekave ndërkomunale me ligjin e vitit 2003, nivel ky qeverisës që nuk ekziston në Kosovë, duke e importuar ligjin kroat të bibliotekave të “zhupave” kroate¹. Si rezultat, funksionimi i këtyre institucioneve ishte vënë seriozisht në rrezik duke i lënë ato “jetime” në pozicionin statik të pritjes në kufirin mes komunave. Anomali të tjera përfshijnë edhe përkufizimet e ligjit për teatrot, i cili e përkufizon “shoqatën teatrore” që merret vetëm me promovimin e veprimtarisë teatrore apo sanksionimet me numra të premierave dhe aktorëve që duhet t’i ketë Teatri Kombëtar.

1.3. Arti dhe kultura: Hobi i orëve të mbrëmjes

Bisedë e autorit me një të njohur të prindërve të tij para Teatrit Kombëtar në kohën kur autori ishte duke punuar në TK:

- “O mirëdita, sa qenke rritë! Ku po punon? Me çka po merresh?”.

¹ “Zhupat” janë rajonet apo qarqet në Kroaci si nivel i qeverisjes, përpos qeverisjes qendrore e lokale

- “Punoj këtu, në Teatrin Kombëtar”.
- “Jo, jo, mendova kështu a punon diku?....?!”

Ky dialog pasqyron më së miri mendësinë e instaluar për vetë sektorin kulturor. Fatkeqësisht kjo mendësi ka përshkuar edhe nivelet e vendimmarrjes dhe mënyrën e qeverisjes kulturore në Kosovë. Pa i njohur rolin e pashmangshëm që kultura ka në zhvillimet e gjithëmbarshme shoqërore e ekonomike, pa i njohur potencialin ekonomik e shoqëror dhe pa i njohur vlerat e pakontestueshme që kultura i bart në shumë politika ndërsektoriale, ky sektor është konceptuar si një mori aktiviteteve që i shërben për një lloj argëtimi si atyre që e krijojnë edhe atyre që e përjetojnë.

Vazhdimisht shprehjet si “përkrahje” që kanë zënë vend edhe në terminologjinë zyrtare të emërtimit të kodeve buxhetore në autoritetet publike në Kosovë e deri tek ato të komunikimeve të përditshme me zyrtarë të qeverisjes kulturore të llojit “ju kemi ndihmuar sa kemi mundur”, kanë frenuar në masë të madhe vendosjen e premisave të shëndosha për të zhvilluar sektorin dhe si pasojë kanë krijuar një imazh të gjithë jetës kulturore si një qenie e gjymtë dhe e

dekonstruktuar, të cilës vazhdimisht i duhet ndihmë, përkrahje dhe një lloj “ushqimi artificial”.

Një qasje e tillë ka përjashtuar kulturën prej kategorizimeve që i hasim në sektorë të tjerë si fjala bie ndërtimi i rrugëve apo infrastrukturës tjetër quhet “investim për të mirën e përbashkët”, subvencionimi i bujqve “zhvillim ekonomik” apo investimet në sistemin shëndetësor dhe atë arsimor asnjëherë nuk kanë marrë epitetin e “ndihmës”, “përkrahjes” apo “rahmetit”. Me këtë nuk mëtohet të minimalizohet rëndësia e nevojës së qytetarit për infrastrukturë dhe shërbime të tjera të domosdoshme në jetën e përditshme dhe as të barazohet rëndësia e nevojave kulturore me nevojat e tjera bazike për jetën e qytetarit. Kjo analogji thjesht shërben për të qartësuar pikënisjen e të menduarit strategjik kur flitet për zhvillim kulturor.

Përfundimisht, qasja e tillë ka frenuar gati në vend zhvillimin e mirëfilltë të marrëdhënies “ofrues i shërbimeve kulturore” dhe “përfitues i shërbimeve kulturore” që në fakt janë tatimpaguesit, apo ata që paguajnë për këtë shërbim dhe kështu pamohueshëm kanë të drejtën e përfitimit të shërbimeve kulturore të cilësisë së lartë, bazuar

2. Mallkimet

në përzgjedhjen dhe preferencat e tyre, përderisa shoqërisë dhe shtetit i mbetet t'ia ofrojë këtë zgjedhje qytetarit.

Kjo pjesë synon të analizojë ngërçet që kanë penguar apo ndaluar zhvillimin e sektorit e që për bazë kanë mentalitete të krijuara me kohë duke u ngurtësuar në “mallkime” të sektorit, thuajse nuk mund të ndryshohen, rishikohen apo anashkalohen.

2.1. Institucionalofobia dhe burokratomania

Duke qenë se gjatë viteve 90-ta e gjithë shoqëria kosovare ka jetuar në një sistem paralel jashtë institucioneve të regjimit, pas çlirimit etja e institucionalizimit të jetës u shndërrua në një mani dhe me kohë u zhvillua në një fobi që nuk i linte proceset të zhvillohen drejt rrjedhës së tyre normale dhe ashtu siç e diktonte “tregu kulturor”. Kësaj në masë të madhe i kontribuoi edhe administrata e UNMIK-ut, e cila për nga natyra ishte tej burokratike. Duke shpresuar se me shpalljen e pavarësisë dhe me marrjen e përgjegjësive të plota nga ana e institucioneve vendëse do të relaksohet ky ngërç, ndodhi e kundërta, institucionet vendëse me synimin e krijimit dhe forcimit të shtetit vazhduan edhe më tutje drejt institucionalizimit si fenomen dhe burokratizimit si formë

e “ngritjes” së rëndësisë së shtetit dhe instrumenteve të tij. Përderisa ky fenomen edhe mund të jetë frytdhënës në sektorë tjerë, në sektorin e kulturës ndikon në masë të madhe duke krijuar ngurtësime, denigrime të cilësisë dhe pengesa serioze të zhvillimit të jetës kulturore në përgjithësi. Çdo problematikë që lindte në sektor tentohej të zgjidhej me një akt ligjor apo nënligjor dhe autoritetet më pastaj e shfrytëzonin këtë për t’u fshehur e deklaruar se nuk kanë mundësi ligjore për të “ndihmuar” apo “përmirësuar” diçka. Fenomen i tillë ndodhi në kohën kur nga niveli qendror u ndal financimi i teatrove të qyteteve me krijimin e akteve nënligjore dhe më pastaj edhe ligjit për teatrot duke iu lënë gjithë përgjegjësinë komunave për financimin punës së këtyre teatrove. Ministria e Kulturës i financonte ad hoc me një shumë të caktuar të shpërndarë në mënyrë lineare nëpër teatrot e qyteteve pa vlerësuar as fuqinë, performancën, madhësinë dhe seriozitetin e këtyre teatrove, të cilat megjithatë kanë dallime të mëdha. Gjithnjë duke u thirrur në mallkimin se gjoja ligji dhe obligimet e tjera ligjore nuk lejojnë financim më të madh të institucioneve, qoftë atyre publike apo edhe të pavarurave, krijohej një përshtypje se vlera e projekteve të propozuara dhe e potencialit të këtyre institucioneve është shumë e mirë dhe e

madhe, por pengesat ligjore janë ato që nuk e mundësojnë një financim më të denjë.

Kështu, duke krijuar “mallkime ligjore”, të iniciuara nga vetë autoritetet dhe shpesh nga individë me ndikim, qoftë të vendosur brenda institucioneve, përkatësish si këshilltarë të Ministrisë së Kulturës, apo edhe individë tjerë nga jashtë me ndikim në vendimmarrje në Ministri, kanë krijuar këto mallkime dhe në emër të këtyre mallkimeve është krijuar rutina e ndarjes lineare të fondeve pa kurrfarë analize të propozimeve të këtyre institucioneve, bagazhit, potencialit dhe forcës që ato përfaqësojnë në domenet e tyre. Kjo ka krijuar pasoja të pariparueshme duke ua mundësuar institucioneve të dobëta që t’i shfrytëzojnë këto mjete sikur t’i kishte sjellë Babadimri, si një dhuratë e mirëseardhur, përderisa institucionet e tjera me potencë shumë më të madhe kanë stagnuar dhe kanë prodhuar demoralizim e depresion brenda institucioneve të tyre dhe rrjedhimisht edhe përballë publikut të tyre, ku ata operojnë.

Kështu, duke i “mallkuar” edhe institucionet e nivelit qendror si një barrë që Ministria e Kulturës i ka në vartësi të vet, financimi i vazhdueshëm dhe në rritje i këtyre institucioneve është konsideruar si “obligim ligjor” i Ministrisë dhe asnjëherë nuk është

krijuar një marrëdhënie që do të nxiste apo ndëshkonte suksesin apo mossuksesin e këtyre institucioneve. Pa marrë parasysh performancën, niveli i financimit nuk ka ndryshuar dhe rritjet janë bërë në mënyrë lineare për të gjitha institucionet dhe kjo gjithnjë është shprehur si sukses i Ministrisë.

Një “mallkim” tjetër vjen prej instancave më të larta, siç është obligimi i institucioneve publike që të ardhurat vetanake t'i deponojnë në thesarin e shtetit dhe më pastaj të kenë të drejtë t'i shfrytëzojnë për disa lloj shpenzimesh me kërkesa të veçanta. Kjo është e rregulluar sipas një memorandumit me Ministrinë e Financave, i cili është përpiluar fillimisht duke i lejuar institucioneve t'i shfrytëzojnë këto mjete për shpenzime ditore të zyrave dhe objektit, por nuk është rishikuar apo korrigjuar asnjëherë bazuar në nevojat e institucioneve. Dhe kështu është ngurtësuar edhe më tej ky “mallkim” kur institucioneve u janë dashur mjete shtesë si fjala bie për udhëtime jashtë vendit për festivale apo ngjarje të tjera, “mallkimi i memorandumit” i ka ndaluar, duke mos mundur t'i shfrytëzojnë këto mjete për këtë qëllim. Në këtë mënyrë është “mallkuar” edhe mundësia për të prezantuar punën e këtyre institucioneve

që është krijuar nga një masë e majme e financimit publik që iu është bërë këtyre institucioneve. Ky aspekt ka zënë vend në këtë pjesë të punimit duke u alegorizuar si “mallkim” për faktin se ai memorandum mund edhe të rinovohet dhe të rishkruhet bazuar në kërkesat dhe nevojat e institucioneve duke e ndaluar kështu “mallkimin” disa vjeçar që ai e bart.

Duke lënë anash për një moment këtë burokratizim, duhet theksuar se të hyrat vetanake të institucioneve kulturore janë freguesi kryesor i suksesit dhe matja më e mirë e punës së menaxhmentit të një institucioni publik kulturor. Ky matës është indikator kyç në vlerësimin e performancës së institucioneve kulturore në trendet bashkëkohore të politikave kulturore. Ky matës nuk është përdorur asnjëherë në Kosovë për të rishikuar punën e menaxhmentit dhe situata e tillë ka prodhuar edhe anomali që për botën e zhvilluar kulturore jo që janë skandaloze, por edhe komplet të pakuptimta: siç janë rastet kur gjatë gjithë vitit kalendarik 2006 Teatri Kombëtar kishte gjeneruar gjithsej 600 euro të hyra vetanake, apo edhe rasti kur shitja e biletës së parë nga Filharmonia e Kosovës pas më shumë se një dekade të funksionimit bëhet lajm për media. Përfundimisht duke marrë parasysh

burokratizimin (lexo mallkimin) e skajshëm të të hyrave vetanake të institucioneve, është krijuar një fenomeni i pashpjegueshëm për trendet bashkëkohore të menaxhimit kulturor: Institucionet qendrore kulturore nga rreth 91 mijë euro (e që është një shumë tepër e vogël krahasuar me buxhetet që kanë pasur në dispozicion), sa kanë gjeneruar në 2008, të bien në 20 mijë euro në 2011 dhe të mbesin në atë nivel edhe në 2012, me rreth 25 mijë. Ky fenomen bëhet edhe më i pashpjegueshëm për faktin se buxhetet e tyre gjatë kësaj periudhe janë rritur në masë bukur të madhe, përdërisa rënia e të hyrave vetanake është më shumë se 4 herë. Shprehur në përqindje, krahasuar me vitin 2008 në 2011, rënia është 455% dhe në 2012 - 358%.²

Një tjetër aspekt i marrëdhënies së institucioneve qendrore kulturore dhe Ministrisë së Kulturës, që ka rënë si “mallkim” mbi fondet publike, janë edhe shpenzimet operationale dhe investimet publike, të cilat merren si të qena dhe administrohet drejtpërdrejt nga Ministria e Kulturës, përmes Ministrisë së Financave. Ky centralizim “i mallkuar” ka prodhuar një mori problemesh që kanë dëmtuar në masë shumë të madhe

funksionimin e institucioneve, e me këtë edhe jetën kulturore të qytetarit, por edhe paranë publike. Kjo nënkupton që menaxhmenti i institucioneve kulturore nuk ka në duart e veta punëtorët të cilët punojnë për këtë menaxhment, përdërisa nuk është në situatë që të administrojë të ardhurat e tyre dhe nuk ka mundësi as të stimulojë e as të penalizojë punën, mos punën apo shkeljet drastike që normalisht në një situatë të tillë ndodhin çdo ditë në institucionet qendrore kulturore. Për më shumë ekziston një plejadë e tërë njerëzish e personash të njohur e të panjohur në këtë listë pagash që ekzekutohen qorrazi nga Ministria e Financave, e të cilët, në shumicën e rasteve, kanë qenë në afërsi me pushtetin, që ka pasur përsipër kulturën varësisht prej kohës kur ata kanë filluar këtë “marrëdhënie (mos)pune”. Duke u trajtuar si “mallkim” edhe kjo pjesë e shpenzimit publik ka mbetur si zorrë qorre, ku kanë zënë vend parazitët të pa akomoduar diku tjetër. Kjo përpos që ka krijuar keqpërdorim të parasë publike, ka krijuar edhe efektin tjetër: buxhetet e institucioneve qendrore kulturore deklarohen për opinion vetëm për “buxhetet e projekteve” dhe kështu fshihet një faturë shumë e madhe të cilën “pa vetëdije” e paguan qytetari.

² Raport i hulumtimit “Politikat kulturore dhe ndarja buxhetore për kulturën në Kosovë, Dren Pozhegu për Forumin Kulturor, tetor 2014, Prishtinë.

2.2. Duke e ëndërruar shpërthimin e madh kulturor nga vendi i vogël

Kjo pjesë mëton të shtjellojë “mallkimin” e madh që ka rënë mbi supet e kulturës në Kosovë, duke kërkuar një prodhimtari artistike apo një kulturë që do të jetë bombastike për gjithë botën, një diçka shumë e madhe e përmasave epike që do të mahnitë botën. Kjo ëndërr për të krijuar gjëra të mëdha, të komplikuara e megalomane ka lënë pothuajse në pozicionin statik vetë zhvillimin e sektorit dhe rrjedhimisht akterëve të saj, duke shterur plotësisht si burimet po ashtu edhe kapacitetet që ka sektori kulturor në Kosovë. Për të qenë “mallkimi” edhe më i madh, kjo qasje në mënyrë të vazhdueshme ka ardhur si nga autoritetet kulturore, ashtu edhe nga vetë akterët kulturorë, përkatësisht prodhuesit dhe shërbyesit kulturorë.

Në emër të diplomacisë kulturore janë ndërmarrë iniciativa për eksporte kulturore pa analizë të mirëfilltë mbi kualitetin e përfaqësimit, përcaktimin e audiencës si dhe impaktin e vet ndërmarrësisë. “E kemi përfaqësuar denjësisht Kosovën”, ka qenë jehona që ka përcjellë pothuajse çdo prezantim kulturor të çfarëdo niveli, duke e ushqyer kështu këtë nevojën “megalomane” të kulturës kosovare.

Një “mallkim” i tillë ka për pasojë edhe një diçka tjetër: sindromën halucinative “Rita Ora”. Rastet e sukseseve individuale botërore, siç është Rita Ora, por dhe shumë raste tjera, ka pasur tendencë që të “birësohen” si suksese të Kosovës, në veçanti nga ana e autoriteteve kulturore. E vetmja meritë që do të mund t’i atribuohet politikave kulturore të Kosovës është fakti se moszhvillimi kulturor ka ndikuar në kualitetin e ulët të jetës së qytetarit (përpos aspekteve të tjera) dhe kështu ka ndikuar që këta individë të braktisin Kosovën dhe të gjejnë suksesin e tyre jashtë. Dhe kështu, siç është karakteristikë e sindromave halucinative, duke krijuar këtë iluzion, politikbërja kulturore në Kosovë nuk ka arritur që të paktën të analizojë rrugën e përshkuar të suksesit të këtyre individëve. Nga kjo analizë e suksesit të këtyre individëve të paktën do të krijoheshin shembuj për ndërmarrjen e politikave kulturore, të cilat do të krijonin e shumëfishonin këto suksese të nisura nga Kosova dhe ambienti i saj kulturor.

2.3. Gjithçka 1 euro - Të gjithë të lumtur në parajsën kulturore

Përderisa shumica e burimeve dhe kapaciteteve janë shpenzuar për ëndrrën e shpërthimit të madh kulturor nga vendi i vogël si dhe me mallkimet tjera burokratike e institucionaliste, me mbetje është synuar lumturia e të gjithëve, të gjithëve pa përjashtim, duke shpërndarë financime në numër sa më të madh të mundshëm projektsh. Ky efekt që i ngjason derdhjes së mililitrave të epruvetës testuese të ujit magjik në oqeanin në të cilin po mbyten speciet e rralla, ka prodhuar “mallkimin” e radhës që e ka “miniaturizuar” kulturën në Kosovë.

Gjithnjë në vazhden e prodhimit të “mallkimeve ligjore”, Ministria e Kulturës për krejt këto 15 vite, me përjashtime sporadike, është sjellë si Ministri e vetëm tetë institucioneve në vartësi të saj dhe për gjithë pjesën e mbetur të jetës kulturore ka konsideruar se nuk ka ndonjë obligim apo përgjegjësi për të financuar, por thjesht mundohet të ndihmojë aq sa mundet. Vënia në pozicionin e “ndihmuesit” domosdoshmërisht imponon mendësinë e shpërndarjes secilit nga pak duke u tentuar me çdo kusht një lloj

barazie bazuar në masën e financimit respektivisht subvencionimit. Për më shumë, numri i projekteve të financuara gjithnjë është promovuar si indikator i suksesit pa asnjë vlerësim të cilësisë apo ndikimit të këtyre projekteve. Efekti në terren ka rezultuar me potencial të derdhur kot e të humbur, pasi që masa e ulët e financimit të këtyre kërkesave nuk ka pasur potencën e krijimit të aktiviteteve apo shërbimeve të cilësisë së dëshiruar. Shumë shpesh subvencionimi është përkthyer në përfitim personal të parashtruesit të kërkesës gjithnjë falë mekanizmave të munguar nga vetë financuesi që të gjithë marrëdhënien me kontraktuesin e ka mbyllur me mbylljen e avancit përballë faturave të prezantuara. Megjithatë, edhe vetë përmbyllja e avanceve mbetet shumë problematike³. Për të qenë më konkret: Një përfitues i subvencionimit ka për obligim që të raportojë vetëm shpenzimet e projektit me fatura për të mbyllur avancin dhe çfarëdo mekanizmi tjetër i matjes së suksesit së projektit nuk ekziston.

³ Raport i hutumtimit “Politikat kulturore dhe ndarja buxhetore për kulturën në Kosovë, Dren Pozhegu për Forumin Kulturor, tetor 2014, Prishtinë.

3. Shanset e humbura – kultura me fajde

Duke u nisur nga elaborimet e pjesëve të mësipërme, gjendja e tanishme në sektorin e kulturës paraqet zbrazëtira të mëdha sa i përket ekspertizës.

Një mori profilesh janë në mungesë në institucionet kulturore, në administratën e Ministrisë e edhe në pjesë tjera publike e jo publike të jetës kulturore në Kosovë. Pa dashur që në këtë punim të bëhet identifikimi i plotë i ekspertizës së munguara në kulturë, është evidente mungesa e madhe e menaxherëve kulturorë, stafit profesional për shqyrtim dhe vlerësim projektesh, e deri te profesionet specifike aq të nevojshëm në përditshmërinë e punës së institucioneve kulturore siç janë kuratorët, por edhe artistë të disiplinave specifike si psh qeramika dhe shumë të tjera në artet pamore, apo inspicientët, dizajnuet dritash, dizajnuet toni, instrumentistë frymorë, mjeshtrë kukullash e shumë të tjerë në artet skenike, apo kuratorët, guidat profesionalë dhe restauratorët në muze dhe pjesë tjera të fushës së trashëgimisë kulturore. Përpos që nuk është ndërmarrë pothuajse asnjë hap për ndërtim kapacitetesh në këto pozicione deficitare, shansi historik për pajisje me ekspertizë të stafit ekzistues apo

edhe krijim të ekspertizës së re duke e stimuluar profesionalizimin në këto aspekte shumë të rëndësishme të jetës kulturore duket se është humbur. Për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të rregullt janë importuar nga jashtë, fjala bie instrumentistë të shumtë për nevojat e Filharmonisë, dhe pa ndonjë analizë të thellë me siguri se kemi shpenzuar deri më tani ndoshta edhe qindra bursa për shkollim dhe profesionalizim të këtyre instrumentistëve të munguar.

Natyrisht që këto shanse nuk janë humbur si pasojë e mungesës së informacionit apo krizave të ideve. Investimet në përfitime afatgjatë asnjëherë nuk kanë qenë pjesë e qeverisjes kulturore në Kosovë. Në mendjen e ministrave të njëpasnjëshëm të kulturës një investim i fillë është parë si shterim i fondeve të cilat ata i kanë projektuar për t'i pasur në menaxhim qoftë për “qarosjen” e atyre që kanë qenë afër pushtetit të tyre por edhe në masë të madhe për të krijuar një marketing politik përmes këtyre mjeteve kulturore në duart e tyre. Ka qenë evidente gjatë shumë viteve se kultura është përkthyer në një zyre dhe buxhet për marketing për partinë që e ka pasur në menaxhim ministrinë, por edhe qeverinë. Aktivitete megalomane

janë organizuar për shënim datash, por edhe raste tjera siç ka qenë ai i shënimit të 125 vjetorit të Lidhjes së Prizrenit në vitin 2003 (jo ndonjë jubile i madh) me një program megaloman që përfshinte përpos tjerash edhe inskenimin e një veprë operistike, e cila u luajt dy net radhazi për të ftuarit e njëjtë sipas protokollit politik dhe kështu iu privua mundësia e blerjes së biletave atyre që kishin pasion për operën e që nuk ishin në listën e të ftuarve, përderisa salla ishte as 30% e mbushur natën e dytë. Kjo pasi që të ftuarit kishin qenë natën e parë dhe nuk do të vinin dy net radhazi ta shihnin operën e njëjtë. Në një analizë të thjeshtë, asokohe rezultonte se shumë më lirë kushtonte që numri i përgjithshëm i shikuesve të operës të udhëtonte me klasë biznesi në Vjenë, të vendosej në akomodim me 5 yje dhe të shikonte operën më të shtrenjtë vjeneze. Anomali të tilla pa as edhe një analizë bazike kanë ndodhur në mënyrë të vazhdueshme dhe kjo flet më së miri për qasjen që qeveritarët kulturorë kanë pasur për kulturën.

Përfundimisht, duke parë shpenzimet që janë krijuar për të përmbushur atë që nuk ekziston i ngjason një jetese me fajde për një kohë shumë të gjatë. Prandaj, krizat dhe niveli zero i zhvillimit në këtë

lloj “stili jetese” janë të pashmangshme. Sigurisht që deficitet profesionale dhe ekspertizën që akoma nuk ekzistojnë në Kosovë i kemi blerë për të dhjetën apo njëzetën herë deri më tani.

Një mënyrë e tillë e të vepruarit ka rezultuar edhe me humbje të potencialit njerëzor. Duke qenë sektor i pazhvilluar edhe ai potencial njerëzor që ka ekzistuar e që ka mundur të zhvillohet në fushat e munguara është tretur duke e gjetur veten në sektorët tjerë apo shpesh edhe jashtë vendit.

4. Vendosja e trendit zhvillimor në kulturë

Marrja për bazë e përvojës nga e kaluara garanton gjithnjë një rishikim politikash që është i bazuar në realitet.

Në këtë mënyrë ngushtohet skajshmërisht mundësia e krijimit të strategjive dhe politikave kulturore që për bazë kanë përmbushje ëndrrash apo vizionesh të individëve pa u bazuar në realitet, gjegjësisht në potencialet dhe mundësitë ekzistuese.

Kështu ky punim tenton që në mënyrë të përgjithësuar, bazuar në përvojën, analizën e potencialit dhe mundësive, të parashtojë një rrafsh që do të mundësonte vendosjen e trendit zhvillimor në sektorin e kulturës në Kosovë, gjithnjë duke planifikuar në mënyrë strategjike zhvillimin e sektorit të kulturës duke i mundësuar kështu kulturës të luajë rolin vital që ka në planifikime dhe politika të tjera publike ndërsektoriale. Me këtë zhvillim edhe do të rritej niveli i kualitetit të jetës kulturore për qytetarin dhe kjo ndikon në masë të madhe rritjen e cilësisë së jetës në përgjithësi, çka është edhe thelbi i shërbimit dhe financimit publik në një shoqëri të hapur e demokratike.

Duke mos përjashtuar aspekte shumë

të rëndësishme dhe problematika të veçanta si të sektorit kulturor, ashtu edhe të nënsektorëve brenda kulturës, në vijim do të përmbliidhen përgjithësisht aspektet jetike dhe parimet e krijimit të trendit zhvillimor në sektorin e kulturës në Kosovë.

4.1. Matja, identifikimi i potencialeve dhe analiza e mundësive

Duke u nisur nga mendime, praktika dhe trende të shumtë si në sektorët e tjerë, por edhe në sektorin e kulturës në shoqëritë bashkëkohore demokratike, matja, vlerësimi dhe identifikimi i potencialeve dhe mundësive është bazë për çfarëdo lloj zhvillimi. Në një mënyrë apo tjetër, në përditshmërinë tonë ne bëjmë matje të shumta dhe identifikojmë shumë potenciale e mundësi, por edhe dobësi e pengesa, megjithatë duke mos i bërë ato në mënyrë sistematike dhe duke mos i pasuar me plane strategjike qoftë të tejkalimit të pengesave e dobësive, qoftë të shfrytëzimit të potencialeve dhe mundësive, ne me apo pa vetëdije e ndalojmë zhvillimin për të mos thënë e përjashtojmë tërësisht.

Thënie të njohura si ajo e Peter F. Drucker se “ajo që matet edhe përmirësohet”⁴

⁴ http://www.goodreads.com/author/quotes/12008.Peter_F_Drucker

janë bazë për ndërmarrësi të shumta të trajtimit të problemeve kur është fjala për menaxhim qoftë brenda organizatës e sektorit po ashtu edhe në nivele shtetesh e shoqërisht.

Duke mos pasur të dhëna është pothuajse e pamundur edhe intervenimi për përmirësim. Edhe pse hulumtimet dhe matjet në sektorin e kulturës në Kosovë pothuajse nuk kanë ekzistuar, ka filluar një punë e akterëve të pavarur në sektorin e kulturës për të sjellë këtë trend, sidomos një mori hulumtimesh e studimesh në kuadër të iniciativës për prodhim të dijes në sektorin e kulturës është ndërmarrë nga Forumi Kulturor, rrjet i organizatave të pavarura të Kulturës të Kosovës, pjesë e së cilës është edhe ky punim. Ky trend i filluar është një domosdoshmëri për të vendosur premisa zhvillimore në sektor. Duhet të maten të gjitha aspektet e funksionimit të jetës kulturore për të pasur mundësi të thurim plane për përmirësim, shmangie, evitim e eliminim të mangësive por edhe rritje, eksploatim e fuqizim të mundësive.

Përmbledhje e studimeve dhe të dhënave ekzistuese, por dhe inicimi i studimeve të tjera duhet të ndërmerret për të krijuar një pasqyrë të plotë të gjendjes

në terren. Më pas trendi i matjes dhe i intervenimit, bazuar në rezultate, duhet të bartet edhe deri në fushat më të ngushta të nënsektorëve kulturorë dhe brenda institucioneve kulturore.

Për të mos qenë shumë abstrakte kjo problematikë, në vijim po paraqesim disa lloje të indikatorëve matës dhe domethënien e tyre.

Gjendja Ekzistuese	Referencat krahasuese	Komentimi dhe nevoja për veprim
Në vitin 2011 Kosova shpenzoi 6.3 € për kokë banori ¹ për nevojat e tij kulturore (shpenzimi më i ulët në të gjithë Europën)	Moldavia (7.7 €), Gjeorgjia (9.3 €), Maqedonia (24.5 €) dhe Serbia (15 € vetëm niveli qendror) Norvegjia (446 €), Zvicra (235 €), Azerbejxhani (39 €) ²	Matjet e tilla dhe krahasimet flasin qartë për nevojë të domosdoshme të rritjes së buxhetit të kulturës në Kosovë. Rezultatet do të duhej të projektoheshin për të arritur Moldavinë dhe synim afatgjatë të jetë Azerbejxhani.
Në vitin 2012 institucionet vartëse të MKRS kanë gjeneruar të hyra vetanake 25.457 €. Po këtë vit, këto institucione kanë operuar me një "buxhet projektesh" në total prej 1.5 milionë euro dhe duke mos pasur të dhëna të sakta të kostove tjera për paga dhe shërbime fatura totale e këtyre institucione ndaj parasë publike mund të jetë rreth 2.5 milionë euro sipas përqindjes që ekziston në disa institucione mes buxhetit të projekteve dhe koston totale.	Në vitin 2012 vetëm Teatri ODA (teatër i pavarur) ka paguar në arkën e shtetit rreth 46.0004 euro në formën e taksave nga aktiviteti i vjetor pa llogaritur impaktin e përgjithshëm ekonomik. Po këtë vit teatri ODA është subvencionuar nga MKRS me 10.000 euro. (Teatri Kombëtar rreth 500.000 në përgjithësi gjegjësisht 300.000 për projekte)	Këto të dhëna flasin qartë për një orientim masiv të financimit të verbër të institucioneve publike të kulturës pa matje të performancës (kuota e të hyrave vetanake 0.1%) si dhe mos njohje e plotë e punës së sektorit të pavarur. Këto të dhëna do të duhej të projektonin një përpjekje emergjente për të zvogëluar këtë dallim enorm gjithnjë duke pasur parasysh edhe të dhëna tjera të performancës që nuk janë pasqyruar këtu.
Financimi publik i institucioneve qendrore kulturore në Kosovë është në masën më shumë se 99%.	Praktikat europiane bashkëkohore të financimit publik të institucioneve kulturore prej 50-80% varësisht prej vendit dhe politikave kulturore. Teatri ODA gjeneron nga të hyrat vetanake mesatarisht 28% të buxhetit vjetor. ⁵	Kushtëzimi i institucioneve kulturore me të hyra vetanake në raport me financimin publik bëhet me qëllim të stimulimit të punës së menaxhmentit dhe kujdesit të shtuar në kontraktime shërbimesh përfshirë edhe ato artistike. Menaxhmentet janë shumë më dinamike në ofrim të shërbimeve cilësore për qytetarin (audiencën).

1 Raport i hulumtimit "Politikat kulturore dhe ndarja buxhetore për kulturën në Kosovë, Dren Pozhegu për Forumin Kulturor, tetor 2014, Prishtinë

2 Raport i hulumtimit "Politikat kulturore dhe ndarja buxhetore për kulturën në Kosovë, Dren Pozhegu për Forumin Kulturor, tetor 2014, Prishtinë - nga burimet: Buxheti i Kosovës (kalkulim i autorit) dhe Compendium (www.culturalpolicies.net)

3 Po aty

4 Raporti vjetor financiar i Teatrit ODA, Prishtinë, mars 2013

5 Kalkulim i autorit nga raportet financiare të pesë viteve të fundit të Teatrit ODA

Duke ilustruar me këta shembuj të përgjithshëm sa për të treguar tendencat dhe trendet, mund të konkludojmë se matjet dhe analizat krahasuese na shërbejnë në mënyrën më të mirë për të krijuar politika kulturore të bazuara në realitet, të cilat maksimalizojnë mundësinë e zhvillimit të sektorit dhe atëherë i japin kulturës vendin meritë në zhvillimet shoqërore duke qenë katalizator i rëndësishëm dhe duke zënë vendin meritë në politikëbërjen e përgjithshme në vend.

4.2. Praktikimi i politikave bashkëkohore të zhvillimit kulturor

Nëse paramendojmë situatën që kemi çliruar ato që u identifikuan si frena të zhvillimit kulturor dhe kemi larguar “mallkimet” që kanë rënë mbi sektor, kemi siguruar që të mos humbim shanset e ndërtimit të potencialit dhe kapaciteteve në sektor dhe më pas kemi futur mendësinë e matjes dhe analizës atëherë do të duhej të instalonim praktika të politikave të vërtetuara të zhvillimit kulturor në mënyrë që sektori të krijojë bazat e shëndosha për zhvillim dhe qëndrueshmëri.

4.3 Krijimi i terreneve fertile për zhvillim

Zhvillimi i sektorit në mënyrën e duhur e sidomos aspektet e veçanta të funksionimit të përditshëm të jetës kulturore është i paimagjinueshëm pa një investim të mirëfilltë në pjesën e kërkimit artistik e kulturor dhe ngritjen e kapaciteteve të sektorit. Duke u nisur nga praktikat botërore, e sidomos bazuar në gjendjen e përgjithshme të kulturës në Kosovë, së paku një e treta e investimit të parësë publike do të duhej të orientohej në të fushë. Ky investim do të arrinte potencialin e plotë duke iniciuar: konkurse të veçanta e me buxhet të dedikuar për projekte të: kërkimit artistik e kulturor, ngritje të kapaciteteve dhe art e kulturë në edukim. Padyshim që një sinergji e mirë me sektorë të tjerë do të mund të shumëfishonte kapacitetin financiar publik që posedon aktualisht kultura në të gjitha nivelet, krijimin e instituteve të specializuara në fusha të caktuara të ekspertizës që dalin si priorite nga rezultatet e “matjeve” paraprake, kushtëzimin e pjesës së programit dhe me këtë edhe të buxhetit të institucioneve kulturore që i dedikohet aspektit edukativ e kërkimor, kushtëzimin e aktivitetit programor të institucioneve në pjesëmarrje më të gjerë të qytetarit duke ofruar kështu

shërbime shtesë, sidomos edukative duke e pasuruar kështu dhe zhvilluar më shumë marrëdhënien mes qytetarit (përfituesit të shërbimeve) dhe ofruesit të shërbimeve kulturore (sektorin), bursa për edukim të specializuar për ekspertizën e munguar, e dalë si prioritet gjatë “matjeve” të bëra paraprakisht me kontrata specifike për kontribut të obliguar pas përfundimit të edukimit, forma të konkursit për mbështetje financiare, por edhe krijim të hapësirave kulturore për zhvillimin e artistëve të rinj në fillim të karrierës.

Duke mos tentuar që të krijohet një listë e mbyllur, këto janë disa nga hapat e nevojshëm e të domosdoshëm që do të ndërtonin në masë të madhe një terren me përfitime të shumëfishta që do të zhvillonte sektorin. Ky aspekt i zhvillimit është i pamundur të iniciohet apo realizohet nga burime tjera përpos financimit publik, për shkakun se përfitimi nuk është i drejtpërdrejtë dhe konkret, andaj interesi i përfitimit dhe zhvillimit afatgjatë do të duhej të ishte ekskluzivitet i politikës publike kulturore dhe rrjedhimisht i financuar nga paraja publike.

4.4 Fuqizimi i parimeve të meritokracisë

Shpërndarja lineare e financimit në sektorin e kulturës në Kosovë është shembulli më i mirë i mundshëm për të argumentuar se një qasje e tillë krijon mbyetje të iniciativës kulturore, shpërdorim dhe keqqeverisje, depresion institucional dhe përfundimisht prodhon stagnim absolut në kuptimin e zhvillimit. Gjithashtu edhe financimi “i verbër” që i është bërë institucioneve pa marrëdhënie meritokratike dhe pa kushtëzim rezultatesh “të matshme” prodhon “dembeli” por edhe “delikuencë kulturore”.

Për të futur mendësinë zhvillimore dhe stimulimin e punës dhe vlerave kulturore do të duhej të instalohet sistemi i financimit publik i bazuar në meritokraci dhe këtu nuk duhet bërë gabimi që merita të valorizohet me numra. Merita në këtë rast do të duhej të matej përmes disa faktorëve varësisht prej fushave dhe profileve të përfituesve të financimit publik. Për të krijuar këtë sistem duhet që konkurset për financim publik të jenë të ndara së paku për këto kategori:

- iniciativat e artistëve të rinj,
- programet ekzistuese të institucioneve të pavarura kulturore,
- festivalet kulturore,

- projektet edukative e kërkimore,
- mobilitetin kulturor.

Varësisht prej nevojës dhe politikave të krijuara kulturore si rezultat i këtyre nevojave të identifikuar nga “matjet” mund të krijohen edhe konkurse të veçanta me specifika shumë të ngushta dhe me kritere precize.

Konkurset kulturore, siç janë edhe në fushat tjera, duhet të kenë kritere të precizuara mirë, fushë-mbulueshmëri të qartë dhe bazuar në kritere të qarta është shumë e lehtë edhe puna e vlerësimit të projekteve dhe propozimeve të paraqitura nga ana e vlerësuesve kompetentë.

Përderisa një standard i tillë të vendoset në përgjithësi në sektorin e kulturës edhe institucionet publike kulturore do të mund të funksiononin shumë më lehtë, duke krijuar politika nxitëse dhe duke kushtëzuar masën e financimit publik të këtyre institucioneve varësisht prej: sasisë dhe cilësisë së shërbimit që i bëjnë qytetarit, sasisë dhe suksesit të programit edukativ, kërkimor e pjesëmarrës që kanë brenda programit të tyre, vlerësimit të nivelit artistik e kulturor të prodhimit artistik e kulturor.

4.5 Kritika artistike e kulturore

Një aspekt i rëndësishëm e jetik i zhvillimit kulturor pothuajse krejtësisht i pazhvilluar në Kosovë është kritika artistike e kulturore. Vendosja e parimeve të meritokracisë nuk mund të bëhet pa kritikë kredibile dhe profesionale. Shërbimet kulturore të të gjithë operatorëve kulturorë duhet të valorizohen nga persona të besueshëm si për qytetarët që i gëzojnë këto shërbime ashtu edhe nga vetë operatorët që i ofrojnë ato. Mungesa e kritikës artistike e kulturore ka krijuar një anarki në sektor në të dy anët. Në njërin anë vetë ofruesit e shërbimeve janë në amulli, duke mos pasur një sy të jashtëm që i vlerëson, shpesh kemi hasur kur vetë artistët vlerësojnë punën e tyre apo vetë drejtuesit e institucioneve notojnë performancën e institucioneve që i drejtojnë. Amullia edhe më e madhe është në anën tjetër, në anën e qytetarëve, gjegjësisht publikut i cili në mungesë të një orientimi nga një kritikë kredibile ka krijuar një çorientim të skajshëm duke rezultuar edhe me paragjykim shumë të dëmshëm: pa pjesëmarrje në shërbimet kulturore është krijuar besimi se ajo që krijohet kulturalisht në Kosovë nuk është e vlefshme.

Përfundimisht, zhvillimi i kritikës së mirëfilltë artistike e kulturore i besueshëm për qytetarët pikë së pari

por edhe për vetë sektorin është aspekt jetësor i krijimit të një hierarkie kulturore me valorizim të saktë të asaj që ofrohet publikut dhe në këtë mënyrë publikut i ofrohet një guidë që e udhëheq atë për përfitim të shërbimeve kulturore. Zhvillimi i kritikës mundëson që publiku të gjejë medium e tij/saj të besueshëm që do të orientonte atë drejt asaj që për të përfaqëson vlerë dhe cilësi. Natyrisht që zhvillimi më i madh do të mundësonte edhe varietet dhe mundësi më të madhe që secili të gjejë kritikun e tij të preferuar që nuk e tradhton.

Zhvillimi i këtij segmenti shumë të rëndësishëm është i pamundshëm pa investime publike. Duke qenë segment që nuk sjell përfitime të menjëhershme, mbetet segment që ekskluzivisht duhet të zhvillohet me insentivën e fondeve publike dhe edhe këtu ka vend të madh për koordinim dhe sinergji me sektorët tjerë si fjala bie me atë të arsimit dhe mediat.

4.6 Decentralizimi dhe depolitizimi

Praktikat më të mira bashkëkohore kanë treguar se qasjet decentralizuese dhe depolitizuese kanë qenë faktorët kryesorë të zhvillimit të hovshëm në sektorin kulturor. Për të arritur këtë standard duhet edhe evoluim i mëtejshëm i mendësisë

politike në Kosovë dhe do të duhej të fillohej me parime të përgjithshme të qeverisjes së mirë duke:

- mundësuar përfshirje të ekspertëve në vlerësimin e performancës kulturore si të akterëve të sektorit ashtu edhe të vet sektorit në përgjithësi,
- krijuar bazë ligjore por edhe praktika funksionale të përditshme që sigurojnë autonomi të plotë të institucioneve kulturore duke decentralizuar kështu edhe sistemin e tanishëm financiar dhe duke mundësuar institucionet që të qeverisin vetë me buxhetet e tyre në mënyrë autonome duke pasur qasje edhe në pagat që ata i paguajnë të punësuarve, por edhe mallrat dhe shërbimet që i prokurojnë për nevojat e programeve dhe funksionimit të tyre, gjithnjë duke qenë të kontrolluar financiarisht nga nivelet gjegjëse të shtetit,
- krijuar trupa nga ekspertë dhe njohës të fushës pa ndikime politike që do të jenë kredibil për emërim drejtuesish dhe vlerësim të performancës së tyre,
- krijuar politika kulturore që mbështesin zhvillim kulturor në nivelin që i takon, MKRS në nivel të Kosovës dhe komunat në nivelin e tyre përkatës të qeverisjes.

Këto politika do të mundësonin që MKRS të ishte përgjegjëse ndaj kulturës që krijohet e kultivohet në të gjithë territorin e shtetit, pa u vetëmjaftuar me financim të një liste “institucionesh vartëse” të saj dhe në anën tjetër Komunitat do të ishin gjithashtu përgjegjëse ndaj kulturës së krijuar në tërë territorin e komunës (jo vetëm qytetet), gjithashtu pa u vetëmjaftuar me listë “institucionesh e aktiviteteve” të përkrahura. Kjo politikë e bazuar në kritere e meritokraci të valorizuara nga vlerësime kredibile mundësojnë kthimin e parasë publike atyre që e investojnë, për nivelin e MKRS, qytetarëve të Kosovës dhe nivelimin komunal, taksapaguesve të komunës përkatëse, krijuar bazë ligjore të heqjes së kompetencave të nivelit politik për emërimet e drejtpërdrejta të këshillave, drejtorëve e bordeve, por duke krijuar procese që sigurojnë se këto vende zihen nga personat me përvojë dhe autoritet në fushat përkatëse dhe kështu duke maksimalizuar performancën në jetën e përditshme kulturore, niveli politik do të ishte i përqendruar në atë që është qenësore: krijimit të politikave kulturore që sigurojnë zhvillim dhe njëherit përmbushje të programit zgjedhor që e ka sjellë në pushtet.

Qasje gjithëpërfshirëse ndërsektoriale Duke e izoluar kulturën brenda kornizave të saj sektoriale dhe duke e minimizuar në një listë aktiviteteve bëjmë gabimin fatal që i gjymtojmë asaj fuqinë dhe potencën që e ka në zhvillimin shoqëror. Akterët kulturorë dhe politikëbërësit kulturorë duhet të jenë shumë dinamik dhe aktiv në politikëbërjen e shumë sektorëve të rëndësishëm të shoqërisë. Kultura zë vend të posaçëm dhe me rëndësi në shumë fusha dhe nuk do të duhej neglizhuar asesi. Aspekti kulturor është shumë i rëndësishëm të merret parasysh kur krijohet politika zhvillimore për ekonomi e turizëm, punësim, mjedis, planifikim hapësinor, marrëdhënie të jashtme, diplomaci, qeverisje lokale, zhvillim të diasporës, zhvillim të sportit, fuqizim të rinisë dhe shumë aspekte të tjera të funksionimit të përditshëm shoqëror.

Për t’u siguruar një qasje e tillë duhet gjithsesi të krijohet mekanizma që do të siguronin marrjen parasysh të aspektit kulturor në proceset e politikëbërjes në përgjithësi dhe me theks të veçantë në sektorët që u përmenden.

5. Kultura në lëvizje – hapat e ardhshëm

4.7. Krijim i procesit gjithëpërfshirës për mendim kreativ e strategjik për trasim të rrugës së zhvillimit kulturor

Përfundimisht një proces i politikëbërjes kulturore në Kosovë do të kishte rezultate të pavërejtura nëse nuk sigurohet një proces gjithëpërfshirës duke shterur potencialin që ka sektori për krijim të mendimit kreativ e strategjik në mënyrë që të garantohet zhvillim dhe qëndrueshmëri.

Krijimi i politikave bashkëkohore kulturore përjashton mendësinë e prodhimit të një liste detyrash si krijimi i një numri aktesh legislative si agjendë, apo edhe krijimi i një strategjie si të vetme. Politikat e mirëfillta kulturore krijojnë procese të qëndrueshme të planifikimit strategjik, gjithëpërfshirjes, konsultave si proces të gjithëkohshëm që i paraprijnë dhe i përcjellin zhvillimet kulturore në vend.

Gjithëpërfshirja do të duhej të konceptohej më shumë në rrafshin e konsulencës me atë që nuk është dëgjuar. Duke krijuar politika zhvillimore duhet t’iu kushtohet kohë dhe rëndësi dëgjimit të atyre që preken çdo ditë nga jeta kulturore, përfituesve, qytetarëve dhe atyre që e ofrojnë këtë përfitim, akterëve të kulturës.

Për të përmbledhur dhe për të siguar një zhvillim të qëndrueshëm kulturor hapat e rëndësishëm që duhet të ndërmerren duhet të fokusohen në:

- heqjen e pengesave së pari brenda nesh dhe më pastaj edhe në legjisllacion dhe akte normative për të mundësuar eliminimin e stereotipave të krijuara me vite të quajtura në këtë punim si “frenime” dhe “mallkime”,
- analizimin e shanseve të humbura në të kaluarën për të mos përsëritur gabimet strategjike që janë bërë për kohë të gjatë,
- vendosjen e mendësisë së matjes duke identifikuar kështu qartazi potencialet dhe mundësitë për zhvillim,
- futjen në praktikë të politikave kulturore që sigurojnë investime në edukim e kërkim për të krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillim kulturor,
- fuqizimin e parimeve të meritokracisë duke siguar që çdo investim publik zë vend të duhur duke maksimalizuar rezultatin proporcionalisht me investimin,
- decentralizimin dhe depolitizimin e jetës kulturore në Kosovë për të siguar kështu një jetë kulturore që zhvillohet krahas nevojave shoqërore e pakufizuar nga burokracia shtetërore

6. Verifikimi i politikave kulturore cilësore: pyetje të tjera për t'u pasur në konsideratë

dhe shumë më llogaridhënëse ndaj publikut të cilit i shërben,

- krijimin e sinergjive për vendosjen e kulturës në politikëbërjen e shumë instancave në vend,
- sigurimin e një procesi gjithëpërfshirës si garantë e trasimit të rrugës së zhvillimit kulturor në Kosovë.

Për të siguruar një proces cilësor të politikëbërjes kulturore nuk duhet harruar se:

- Cilat janë mekanizmat e vazhdueshëm për të siguruar kreativitet, performancë të mirë menaxheriale dhe vazhdimësi në institucionet kulturore dhe në jetën kulturore në përgjithësi?
- Cila është potencia kulturore e Kosovës dhe çka është e mundshme dhe reale të projektohet si rezultat?
- A është siguruar konsultimi i të gjithë akterëve që i prek një politikë, përfshirë edhe akterët jashtë sektorit kulturor?
- A është siguruar hapësira e mjaftueshme për konsultim me akterët që preken?
- Cilët janë mekanizmat që do të përfshijnë dhe adresojnë brengat dhe shqetësimet e akterëve gjatë procesit?
- A është konsultuar legjislacioni në fuqi për ndeshjet eventuale që mund të krijohen apo iniciativat për ndryshime legjislative nëse kërkohen?
- Si duhet inkorporuar zhvillimet globale dhe trendet botërore në politikëbërjen kulturore në Kosovë?

Forumi Kulturor

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë.

Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23.03.2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

Forumi Kulturor i Kosovës është Rrjet i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:

- Fuqizimit të organizatave të

pavarura kulturore, duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizimin e programeve të tyre,

- Afirmimit të organizatave anëtare,
- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse,
- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

Forumi Kulturor synon të përmbushë misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:

- Komunikimi dhe rrjetëzimi i organizatave të pavarura në fushën e kulturës
- Shkëmbimi dinamik i informacioneve dhe përvojave
- Aktivitete të lobimit dhe avokimit
- Trajnime specifike për nevojat e organizatave anëtare
- Organizimi i debateve dhe forumeve
- Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore

Forumi për Zhvillim Kulturor

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikatat kulturore të Kosovës.

Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë, e bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe DokuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013, ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dy vjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrjetin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.

www.forumikulturor.net




Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor

